

Roli dhe Përgjegjësitë e Psikologut

Përmbajtja e dokumentit

1.	Ofrimi i Shërbimeve Psikologjike:	3
2.	Roli dhe përgjegjësitë e stafit akademik dhe atij ndihmës akademik	4
3.	Roli dhe përgjegjësitë e institucionit	5
4.	Vlerësimi i efektivitetit të Shërbimit Psikologjik	5
5.	Ruajtja e të dhënave në format elektronik dhe masat e sigurisë kibernetike	6
6.	Menaxhimi i rasteve urgjente e komplekse	6
6.1.	<i>Llojet e rasteve urgjente</i>	7
6.2.	<i>Masat e urgjencës</i>	7
7.	Palët e treta	8
8.	Dokumentimi dhe Raportimi	8

Roli dhe përgjegjësitë e psikologut të shërbimit psikologjik në institucionet e arsimit të lartë janë:

“Shërbimi psikologjik në institucionet e arsimit të lartë luan një rol thelbësor në promovimin e mirëqenies së studentëve, në mbështetjen e zhvillimit të tyre personal dhe akademik, si dhe në garantimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave psiko-emocionale të komunitetit universitar.”

1. Ofrimi i Shërbimeve Psikologjike:

- Ofron mbështetje psiko-emocionale përmes vlerësimit të nevojave të tyre psiko-emocionale duke ofruar ndërhyrje të përgjithshme këshilluese, duke orientuar/referuar rastet më të ndërlikuara drejt shërbimeve më të specializuara, kur kjo vlerësohet si e nevojshme.
- Zbatojnë protokolle të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave sipas Kodit Etik të Psikologut dhe Rregulloreve përkatëse.

Trajnimi dhe Konsulenca për Stafin Akademik dhe Ndhmës Akademik:

- Ofron dhe/ose organizon sesione informuese dhe ndërgjegjësuere për stafin akademik dhe ndhmës akademik, me fokus njohjen e problematikave të shëndetit mendor si dhe të problematikave psiko-emocionale.
- Ofrojnë udhëzime për ndërhyrje të menjëhershme dhe referime të specializuara në raste emergjente.

Monitorimi dhe Vlerësimi:

- Mbajnë dokumentacion të detajuar për seancat dhe ndërhyrjet e kryera, duke siguruar disponueshmërinë e informacionit për vlerësime periodike dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.
- Monitorojnë progresin e ndërhyrjes te studentët, duke përgatitur raporte të rregullta dhe duke bashkëpunuar me të gjitha palët për një proces efektiv.
- Harton raporte vjetore analitike mbi punën e shërbimit psikologjik dhe ia komunikon këtë dekanatit.

Përditësimi Profesional:

- Angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe praktikave të tyre profesionale, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushën e psikologjisë dhe atë të shëndetit mendor përmes trajnimeve dhe aktiviteteve profesionale të ofruara në fushë.
- Ndërmarrin veprimtari kërkimore-shkencore në funksion të përmirësimit të praktikave më të mira të punës së tyre si psikologë në institucionet e arsimit të lartë dhe reflektojnë gjetjet e tyre në praktika të përmirësuara pune me studentët dhe stafin.

2. Roli dhe përgjegjësitë e stafit akademik dhe atij ndihmës akademik

Vëzhgimi dhe Mbështetja:

- Stafi akademik dhe ndihmës akademik është i vëmendshëm ndaj shenjave të mundshme të shqetësimeve psiko-emocionale të studentët gjatë ndërveprimeve akademike dhe sociale.
- Kur vërehen shenja të tilla, stafi e inkurajon studentin të kërkojë mbështetje profesionale, duke i ofruar informacion për shërbimet e disponueshme psiko-sociale brenda institucionit.
- Në raste kur studenti shpreh vetë nevojën për ndihmë, stafi mund të lehtësojë kontaktin me psikologun, gjithmonë me pëlqimin dhe në mirëbesimin e plotë të studentit.

Pjesëmarrja në Trajnime:

- Marrin pjesë në seancat e trajnimit dhe ëorkshop-e të organizuara nga psikologët për të përmirësuar aftësitë e tyre në menaxhimin e situatave psiko-emocionale.
- Marrin pjesë në sesionet informuese dhe ndërgjegjësuere për stafin akademik dhe ndihmës akademik, me fokus njohjen e problematikave të shëndetit mendor si dhe të problematikave psiko-emocionale të organizuara nga psikologu.

Bashkëpunimi dhe Komunikimi:

- Mbajnë një komunikim të rregullt dhe transparent me psikologët dhe administratën për të siguruar një koordinim efektiv në trajtimin e çështjeve të studentëve.
- Respektojnë parimet e konfidencialitetit kur përpunojnë informacionet e ndjeshme lidhur me studentët.

3. Roli dhe përgjegjësitë e institucionit

Politikat dhe Protokollat:

- Harton dhe miraton politika të qarta për promovimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies psiko-emocionale.
- Siguron që rregulloret dhe udhëzimet e lidhura me shërbimet psikologjike janë të përditësuara dhe në përputhje me legjislacionin dhe standardet etike.

Sigurimi i Burimeve:

- Siguron burimet e nevojshme (financiare, teknologjike, infrastrukturore) për organizimin e trajnimeve, seancave psikologjike dhe aktiviteteve mbështetëse.
- Krijon një mjedis që nxit bashkëpunimin ndërmjet psikologëve dhe stafit akademik e ndihmës akademik.

Koordinimi dhe Monitorimi:

- Organizon takime ndër-disiplinore për të rishikuar efektivitetin e shërbimeve dhe për të diskutuar sfidat dhe propozimet për përmirësim.

Mbështetja për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të psikologëve

Institucioni i Arsimit të Lartë ndjek politika promovuese të mbështetjes së zhvillimit të vazhdueshëm të psikologëve përmes:

- Organizimit të trajnimeve të specializuara periodike.** Këto trajnime mbahen nga ekspertë të fushës dhe kanë në fokus përditësimin e shprehive profesionale të diagnostikimit, vlerësimit, ndërhyrjes dhe trajtimit psikologjik.
- Organizimi i seminareve të hapura, konferencave dhe simpoziumeve.** Institucioni inkurajon shkëmbimin e përvojave mes psikologëve të institucioneve të arsimit të lartë duke organizuar seminare, konferenca dhe simpoziume përmes të cilave nxitet adresimi i sfidave në praktikën e punës së psikologëve dhe promovimi i zgjidhjeve inovative.
- Burimet financiare dhe logjistike.** Institucioni siguron fondet dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e trajnimeve, seminareve e konferencave.
- Burimet e nevojshme financiare.** Institucioni siguron fondet në mbështetje të përditësimit profesional të psikologut në institucionin e arsimit të lartë si dhe në procesin e supervizimit profesional të tij.

4. Vlerësimi i efektivitetit të Shërbimit Psikologjik

Performanca e punës së shërbimit psikologjik matet përmes disa mekanizmave me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij shërbimi përmes identifikimit e matjes së efektivitetit të ndërhyrjeve psikologjike, ndikimit të shërbimit psikologjik në mirëqenien psiko-emocionale të studentëve dhe në rezultatet akademike e identifikimit të fushave për përmirësim. Matja dhe monitorimi i efektivitetit të shërbimit psikologjik bëhet përmes:

- a. **Mbledhjes së opinionëve nga studentët:** Realizimi i anketave specifike tek studentët për të matur perceptimet e tyre mbi efektivitetin e shërbimit psikologjik dhe nivelin e kënaqësisë nga ky shërbim.
- b. **Organizimi i fokus grupeve me studentët** për marrjen e të dhënave më të detajuara, sugjerimeve dhe nevojave të tyre mbi përmirësimin e shërbimit psikologjik.
- c. **Matja e mirëqënies emocionale:** Shërbimi psikologjik administron instrumente të standartizuara për matjen e nivelit të stresit e mirëqënies së përgjithshme psiko-emocionale të studentëve me qëllim adresimin në kohë nevojave të tyre. Pjesë e matjes së këtij aspekti është dhe monitorimi i progresit të rasteve specifike individuale për t'u siguruar që praktikatat e ndërhyrjet psikologjike sjellin përmirësime në mirëqënien psiko-emocionale të studentëve.
- d. **Analiza vjetore e punës së shërbimit psikologjik:** Psikologët hartojnë në fund të çdo viti akademik një analizë vjetore të punës së tyre në të cilën përshkruaj aktivitetet e kryera, numrin e rasteve të ndjekura, numrin e rasteve të zgjidhura, numrin e rasteve në proces, të dhënat mbi ndikimin që ndërhyrjet psikologjike kanë patur në rezultatet akademike dhe në nivelin e kënaqësisë së studentëve e në mirëqënien e tyre të përgjithshme psiko-emocionale si dhe konkluzionet e rekomandimet për rritjen e cilësisë së shërbimit në të ardhmen.

5. Ruajtja e të dhënave në format elektronik dhe masat e sigurisë kibernetike

Në rast se të dhënat konfidenciale të studentëve janë pjesë e një sistemi elektronik të dhënash, ato ruhen në server të siguruar me enkriptim të avancuar. Ky sistem përdor formën e identifikimit me shumë faktorë për të siguruar që të dhënat aksesohen vetëm nga personat e autorizuar. Personat e autorizuar për aksesimin e sistemit janë psikologët dhe personeli i IT i institucionit i cili vepron në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të institucionit.

6. Menaxhimi i rasteve urgjente e komplekse

Psikologët dhe administrata e institucionit aplikojnë masa specifike sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje për adresimin e shpejtë, të koordinuar dhe të dokumentuar të rasteve urgjente e që përbëjnë rrezik të lartë për studentët.

6.1. Llojet e rasteve urgjente

- a. **Rastet e gjendjeve psiko-emocionale me rrezik të lartë:** Studentë me ide dhe veprime që paraqesin rrezik për dëmtimin e vetes dhe të tjerëve.
- b. **Rastet e krizave të panikut dhe ankthit ekstrem:** Studentë që kanë episode të papritura të panikut me humbje të kontrollit e rrezikut për shëndetin fizik dhe mendor.
- c. **Sjelljet agresive:** Studentë që shfaqin sjellje aggressive të nivelit të lartë, të tilla që kërcënojnë sigurinë e tyre, të studentëve të tjerë apo të mjedisit shkollor.
- d. **Incidente të abuzimit fizik apo seksual:** Raste të abuzimeve fizike ose seksuale që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.
- e. **Kriza mjekësore me shkaqe organike dhe/ose psiko-emocionale.** Studentë që shfaqin problem të frymëmarrjes, ruajtjes së vetëdijes, dhimbje të forta fizike apo simptoma të tjera fizike të rëndësishme.
- f. **Studentët nën efektin e alkoolit apo substancave të ndryshme.** Studentët nën efektin e alkoolit apo substancave të ndryshme mund të shfaqin sjellje impulsive, mungesë për qendrimi dhe rrezik për veten ose të tjerët.

6.2. Masat e urgjencës

Psikologu, pasi ka vlerësuar nivelin e rrezikut dhe konsideron rastin si rast urgjent zbaton këto hapa:

- a. Njofton autoritetet e brendshme të institucionit (zëvendës dekanin e procesit mësimor/studentëve) dhe konsulton rastin.
- b. Aktivizon dhe aplikon ndërhyrje psikologjike specifike për rastet e krizave dhe emergjencave psikologjike.
- c. Në rastet që përfshijnë kriza mjekësore psikologu në bashkëpunim me autoritetin e brendshëm të institucionit njoftojnë menjëherë shërbimin e urgjencës dhe sigurohen deri kur shërbimi i nevojshëm i jepet rastit.
- d. Në rastet e sjelljeve të rrezikshme si ato të abuzimit fizik apo seksual apo të dhunës në ambjentet e shkollës, psikologu dhe autoriteti i brendshëm i institucionit njoftojnë autoritetet e ruajtjes së rendit.
- e. Në rastet e problemeve psikologjike komplekse kur kërkohet ndërhyrje në aspektin social dhe jo vetëm atë psikologjik e të institucionit, psikologu me dijeninë dhe në konsultim me autoritetin e brendshëm të institucionit, kontakton organet shtetërore të mbështetjes sociale dhe/apo organizata e shoqata të përkrahjes sociale, me të cilat insititucioni ka marrëveshje paraprake për referimin e rastit dhe koordinimin e shërbimeve mes aktorëve.

7. Palët e treta

Në situata ku ekziston rrezik i vazhdueshëm për mirëqenien e studentit, psikologu, **vetëm pasi ka marrë pëlqimin e informuar të studentit**, mund të përfshijë prindërit apo kujdestarët ligjorë në mbështetjen e procesit psiko-social.

Në raste kur psikologu vlerëson se rreziku për dëmtim të vetes ose të të tjerëve është i lartë dhe studenti **nuk pranon vullnetarisht të marrë shërbim psikologjik dhe/ose mjekësor**, psikologu vepron në përputhje me **Kodin e Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” (të përditësuar)** për të mbrojtur jetën dhe shëndetin.

Në përputhje me parashikimet ligjore, psikologu:

- a. Kërkon një vlerësim të dytë profesional nga autoritetet publike të shëndetit mendor.
- b. Koordinon veprimet me këto autoritete për të ndjekur procedurat e nevojshme.
- c. Nëse është e domosdoshme, nis procedurën për trajtim të detyruar, duke u siguruar që janë marrë masa për:
 - i) minimizimin e shkeljes së autonomisë së studentit (në përputhje me parimin e “së mirës më të lartë” dhe “mosdëmtimit”);
 - ii) informimin e studentit për procedurat dhe të drejtat e tij;
 - iii) ruajtjen e konfidencialitetit, duke ndarë informacion vetëm me persona apo institucione të autorizuar me ligj.

8. Dokumentimi dhe Raportimi

Psikologu dokumenton të gjitha veprimet lidhur me menaxhimin e rasteve psiko-sociale, përfshirë datën, orën, natyrën e ndërhyrjes dhe personat e përfshirë, duke respektuar plotësisht rregulloren për ruajtjen e të dhënave konfidenciale të studentëve.

REKTORI
Prof. Dr. Artan HOXHA

